



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 6

Tiranë – E hënë, 15 shkurt 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 24, datë 8.2.2021	Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit të Akademisë së Studimeve Albanologjike, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit..... 3
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 29, datë 9.2.2021	Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike..... 6
Njoftim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 812, datë 12.2.2021	Për aplikim për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik..... 8



URDHËR
Nr. 24, datë 8.2.2021

**PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES
SË ANËTARËVE TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT TË AKADEMISË SË
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE,
MËNYRËN E VLERËSIMIT TË
KANDIDATËVE DHE AFATIN E
DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Akademinë e Studimeve Albanologjike, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave dhe shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, për anëtarë të Bordit të Administrimit, do të jetë deri më datë 20.2.2021.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin

anëtar të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Akademinë e Studimeve Albanologjike, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të kualifikuar do të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT SPORTIT DHE
RINISË
Evis KUSHI

SHTOJCA NR. 1

**NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE
TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES TË MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
AKADEMINË E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE**

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe urdhrit nr. __, datë __.__.2021, të MASR-së, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit të Akademisë së Studimeve Albanologjike, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit për



Akademine e Studimeve Albanologjike, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për bord
1	Akademia e Studimeve Albanologjike	4

1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit, në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;

- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;

- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;

- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;

- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;



- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

- të ketë integritet etik dhe profesional;

- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;

- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL-ja ku kandidon;

- jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV - *Curriculum Vitae*);

- fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën *Bachelor*). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet “Vërtetimi i njohjes dhe njësimit të

diplomës/certifikatës”, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- fotokopje të librezës së punës;

- fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- vërtetim të gjendjes gjyqësore;

- vërtetim i lëshuar nga gjykata;

- vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të jetë deri në datën 15.2.2021 në një nga këto mënyra:

a) me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila vë në dispozicion të Komisionit *Ad Hoc* të ngritur me urdhër ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

5. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen:

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të shpallë kandidatët e kualifikuar në faqen e saj zyrtare, www.arsimi.gov.al.

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit kryhet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 10 ditëve



pune dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Dalja e rezultateve përfundimtare të konkurrimit do të bëhet brenda 10 ditë pune nga data e përfundimit të afatit të aplikimeve.

6. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në Bordin e Administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.

SHTOJCA NR. 1/1 VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE DREJTUESE PARTIAKE

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2 VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e

funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe legjislati në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3 VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

URDHËR Nr. 29, datë 9.2.2021

PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, të vendimit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; të pikës 1 dhe të pikës 5, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786,



datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar, duke qenë se mandati 4-vjeçar i qëndrimit në detyrë i kryetarit dhe i anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, përfundon më datë 24 mars 2021, si dhe me vullnetin për realizimin e një procesi sa më objektiv e transparent për përzgjedhjen e kandidaturave me integritet të lartë moral dhe profesional të përshtatshme për anëtarësim në këtë organizëm,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për kryetar dhe 3 (tre) anëtarë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të cilat pas vlerësimit do të emërohen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë.

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike është organi më i lartë vendimmarrës për mbikëqyrjen publike të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit, organizatave profesionale të audituesve ligjorë, si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, me qëllim përmbushjen e objektivave publike, në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik.

3. Kryetari dhe anëtarët e Bordit ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë, në bazë të përcaktimeve në nenin 5, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, nëpërmjet mbledhjeve dhe marrjes së vendimeve, në përputhje me procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të Bordit të Mbikëqyrjes, të përcaktuara në ligj dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, të ndryshuar.

4. Në mbështetje të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit

ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, kandidatët për kryetar dhe anëtarë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëm:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë integritet moral dhe profesional;
- c) të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;

ç) të zotërojnë, të paktën, diplomë “Master i shkencave” apo të barasvlershëm me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 10 (dhjetë) vjet përvojë ose një gradë apo titull shkencor dhe 7 (shtatë) vjet përvojë pune në çështjet e auditimit ligjor dhe të kontabilitetit;

d) të mos kenë lidhje të afërta, deri në shkallë të dytë, me personat në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

5. Kandidati që përzgjidhet nga institucionet publike të arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, duhet të plotësojë kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të ligjit, dhe të jetë pjesë e stafit të përhershëm të institucionit publik të arsimit të lartë.

6. Kandidatët, që aplikojnë për kryetar dhe anëtarë të Bordit, dorëzojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën me shkrim;
- b) kopje të pasaportës ose të kartës së identitetit (ID);
- c) *Curriculum vitae*;
- ç) dy vlerësimet e fundit vjetore, në rast se kandidati vjen nga institucionet publike;
- d) kopje të noterizuar të librezës së punës;
- dh) kopje të noterizuar të diplomës/diplomave;
- e) vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas përcaktimeve të pikës 4/d sa më sipër;
- ë) kopje të noterizuara të dëshmimeve e të certifikatave të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;
- f) dëshminë e penaltetit



7. Dokumentet e përcaktuara në shkronjën “ë”, të pikës 6 sa më sipër, të përfituara jashtë vendit, duhet të jenë të legalizuara, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohet me postë ose drejtpërsëdrejti në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në adresën: **Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Kodi Postar 1001.**

9. Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga shpallja e këtij njoftimi, duke filluar nga data 10 shkurt 2021 deri më **datë 2 mars 2021.**

10. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit, sipas pikës 2, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar, kryhet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore.

11. Pas administrimit të dokumentacionit, Komisioni *Ad Hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret dhe e paraqet për miratim te ministri i Financave dhe Ekonomisë.

12. Kandidatët e listës, që plotësojnë kriteret ligjore duhet të dorëzojnë “Formularin e vetëdeklarimit”, të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

13. Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së

Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

14. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

NJOFTIM
Nr. 812, datë 12.2.2021

PËR APLIKIM PËR FUNKSIONIN E
ANËTARIT
TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT
PUBLIK

Në mbështetje të neneve 19/2, 19/3 (pikat 1 dhe 3) e 76/3 (pika 4), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 6, të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave për kryetar dhe anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik”, shpallim njoftimin për aplikim për 3 (tre) anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.

Inkurajojmë të gjithë të interesuarit, që përmbushin kriteret, të aplikojnë.

- Aplikanti duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë arsim të lartë në drejtësi ose në inxhinieri, ekonomi apo ndonjë fushë të ngjashme (të paktën dy anëtarë do të përzgjidhen me arsim të lartë në drejtësi, ndërkohë një anëtar mund të përzgjidhet me diplomë në inxhinieri, ekonomi apo ndonjë fushë të ngjashme);
- ç) të ketë mbi 8 (tetë) vjet përvojë pune, nga të cilat, të paktën 3 (tre) vjet në fushën e prokurimeve;



d) të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

dh) të mos ketë masë disiplinore në fuqi dhe të mos jetë larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore.

- Dokumentet që duhet të dorëzohen janë, si më poshtë vijon:

- a) kërkesë për aplikim;
- b) jetëshkrim (*curriculum vitae*) i kandidatit (secila faqe, e firmosur);
- c) diplomë e arsimit të lartë (e noterizuar);
- ç) librezë pune ose dokument i ngjashëm për të vërtetuar përvojën e punës;

d) vërtetim ose vetëdeklarim se nuk është larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore ose që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

dh) formular të vetëdeklarimit (të plotësuar e të firmosur), në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

e) formular të aplikimit (të plotësuar e të firmosur) për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

ë) çdo dokument tjetër shtesë që provon përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, sipas përcaktimit të pikës 11, të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave.

(Deklarimi i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme e konkurrimit dhe përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi.)

- Vlerësimi

Komisioni *ad-hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve, bën vlerësimin paraprak të dosjeve të aplikantëve dhe publikon në web-faqen zyrtare të Kryeministrit listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për t’u përzgjedhur.

Komisioni *ad-hoc*, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së vlerësimit paraprak të dosjeve, bën vlerësimin me pikë të tyre, sipas parashikimit të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave për kryetar dhe anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik”.

Pas vlerësimit të jetëshkrimit, kandidatët mund t’i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë, për të cilën do të njoftohen për datat përkatëse të zhvillimit të saj.

Lista e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik, renditur sipas pikëve të marra, do të publikohet në web-faqen zyrtare të Kryeministrit.

Me qëllim vijimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, Këshilli i Ministrave dërgon në Kuvend listën e kandidatëve të kualifikuar, sipas renditjes dhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për t’u emëruar.

Afati i dorëzimit të aplikimit: Deri më 19 shkurt 2021.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: 04 22 77 401

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021